



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1889/6 prot.

Datë 29.10.2021

V E N D I M

Nr.823/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-06882-09-30-2021, me objekt “*Mirëmbajtje e gjelbërimit në hapësirat publike dhe varrezat e Bashkisë Himarë*”, me fond limit 22,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01-10-2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Ankimues: “6D-Plan” SHPK
Rruga “Jusuf Vrioni”, Pallati Alison, Shk.II, Kati 2,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Himarë
Spile Himarë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë
19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik
Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave
për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.10.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-06882-09-30-2021, me objekt “Mirëmbajtje e gjelbërimit në hapësirat publike dhe varrezat e Bashkisë Himarë”, me fond limit 22,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01-10-2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2. Në datën 06.10.2021 operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 14.10.2021 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë protokollit të KPP-së informacionin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “6D-Plan“ SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “6D-Plan“ SHPK dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesit. Konkretisht me shkresën nr.316 prot datë 11.10.2021 me lëndë vendim mbi shqyrtimin e ankesës së dorëzuar nga OE 6D-Plan SHPK, autoriteti kontraktor (KSHA), ka pranuar pretendimet e ankimuesit si më poshtë .

Lidhur me kriterin e kundërshtuar nga ankimuesi pika 3.2.1. e kapacitetit ekonomik dhe financiar në shtojcën 8 të DT, ku AK ka kërkuar shprehimisht se *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera e së cilës duhet të jetë më e madhe ose sa dyfishi i fondit limit që prokurohet.*

KSHA sqaron, se nisur nga vlera e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, përcaktimi i bërë nga AK në pikën 3.2.1. që vlera e xhiros duhet të jetë më e madhe se sa dyfishi i fondit limit që prokurohet, është hartuar në kundërshtim me gërmën b të VKM nr.285 datë 19.05.2021, pasi kjo vlerë duhet të jetë brenda vlerës kufi të fondit limit prej 22,500,000 lekë pa TVSh. Në procesverbalin e argumentimit vihet re që kriteri është formuluar saktë. Për sa më sipër pretendimi i ankuesit qëndron ndaj vlerësojmë që kriteri të modifikohet nga AK në përputhje me përcaktimet e nenit 43 pikat 2,3 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, si dhe duhet të mbahet në konsideratë fakti që çdo kriter duhet të jetë i unifikuar në të dy dokumentet në DT dhe në procesverbalin e argumentimit të kriterëve.

- Lidhur me kriterin e kundërshtuar nga ankimuesi pika 3.3.1 të kapacitetit teknik, në shtojcën 8 të DT ku AK Bashkia Himarë ka kërkuar shprehimisht: *Shërbime të ngjashme për vitin e fundit në një vlerë sa 40% e fondit limit, ose për tre vitet e fundit sa dyfishi i fondit limit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen: Kur shërbimi është realizuar me Ente Publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit dhe vlera e shërbimit të realizuar. Kur shërbimi është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara) të shoqëruara detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera.*

KSHA sqaron, se përcaktimi i bërë nga AK në kriterin në pikën 3.3.1 mbi vlerën minimale të kontratave të ngjashme dhe dokumentacionit që kërkohet të dorëzohet nga OE për plotësimin e këtij kriteri është në kundërshtim me nenin 41 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021. Pretendimi i ankimuesit qëndron, ndaj vlerësojmë që kriteri të modifikohet nga AK në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

- Lidhur me kriterin e kundërshtuar nga ankimuesi në pikën 3.3.2 të kapacitetit teknik në shtojcën 8 të DT ku AK ka kërkuar: *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licencat e lëshuara nga organet përkatëse, e cila të përmbaje kategoritë e mëposhtme:*

Leje e thjeshtë mjedisore

Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota

Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe/ose fidanëve

- *Leje mjedisore e tipit me kod III.1.A C (për shërbime në sipërfaqet e gjelbëruara)*
- *Licencë me kod III.7.A (Shërbime të ekspertizës dhe profesionale lidhur, me pyje dhe kullota: Shërbime profesionale për zbatime, shërbime profesionale në projekttime, dhe shërbime të ekspertizës dhe certifikimit)*
- *Licencë me kod II.4 (Prodhim dhe tregtim i farërave dhe fidanëve)*

KSHA sqaron se referuar ligjit nr.52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr.10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar, kërkesa për dorëzimin e lejes mjedisore të tipit C (ose leje me kodin III.1.A) është shfuqizuar, pra nuk duhet të kërkohet më. Ndërsa kërkesa mbi dorëzimin e licencës me kod II.4 me aktivitet *Prodhim dhe tregtimi i farërave dhe fidanëve* nuk është e lidhur me natyrën e objektit të kontratës, që AK po prokuron referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës së këtij shërbimi.

- Lidhur me kriterin e kundërshtuar nga ankimuesi në pikën 3.3.5 të kapacitetit teknik në shtojcën 8 të DT ku AK ka kërkuar: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar si staf teknik, i cili duhet të figurojë në licencën e shoqërisë për punonjësit si më poshtë:*

■ *1 (një) Inxhinier Pyjesh, te licencuar **ne zbatim** ne kategorine 14:*

***Kat a** Punime ne siperfaqet e gjelberta, parqe pyll parqe*

***Kat b** Pastrim i siperfaqes urbane*

***Kat c** Kryerja e punimeve ne sherbesa furnerale*

***Kat d** Mirembajtja, zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane*

- *Ne projektim kategoria 2 e "Per projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe te gjelberta, lulishte dhe parqe" për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.*
- *Te kete nje specialist te certifikuar nga organet shtetërore (Ministria e Mjedisit) per projektme, zbatime dhe eksperiza ne fushen mjedisit dhe gjelberimit)*

Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se ankimuesi pretendon modifikimin e kriterit si vijon : Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar përgjatë tre muajve të fundit staf teknik si më poshtë :

- 1 inxhinier pyjesh për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.
- Të ketë një specialist të certifikuar nga organet shtetërore (Ministria e Mjedisit) për projektme, zbatime dhe ekspertiza në fushën mjedisit dhe gjelbërimit).

KSHA sqaron, se kërkesa për disponimin e një inxhinieri pyjesh është e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen. Nevoja për inxhinierin e pyjeve është e domosdoshme nisur nga zërat e shërbimeve që kërkohen të realizohen për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pemëve, konstatimin dhe luftimin e sëmundjeve të ndryshme, kontrollin e krasitjes së pemëve dhe proceseve të tjera teknike si dhe është i bazuar në legjislacionin për pyjet dhe shërbimin pyjor, ndërsa kërkesa, që inxhinieri i pyjeve të jetë i licencuar në zbatim me kategorinë 14 duhet të modifikohet nga AK, pasi një licencë e tillë nuk lëshohet aktualisht nga autoritetet përkatëse. Sa më sipër pretendimi i ankimuesit për këtë kriter qëndron pjesërisht ndaj vlerësojmë, që kriteri të modifikohet nga AK dhe të hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Lidhur me pretendimin e ankimuesit për sqarim mbi fondin limit të procedurës në fjalë KSHA, pasi shqyrtoi DT procesverbalet në dosjen e tenderit, si dhe u konsultua me strukturat përkatëse të AK që janë angazhuar për këtë procedurë prokurimi, ka konstatuar, se buxheti prej 22,500,000 lekë pa TVSh është parashikuar vetëm për 12 muaj, por nga ana e njësisë së prokurimit është bërë një lapsus në vendosjen e afatit dhe nga 12 muaj që duhet të ishte është bërë 36 muaj.

II.5. Sa më sipër me vendimin nr.780/2021 datë 18.10.2021 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "6D-Plan" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr.REF-06882-09-30-2021, me objekt "Mirëmbajtje e gjelbërimit në hapësirat publike dhe varrezat e Bashkisë*

Himarë”, me fond limit 22,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01-10-2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

2. *Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*

3. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “6D Plan” SHPK për modifikimin e kriterit “*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf teknik, i cili duhet të figurojë në licencën e shoqërisë për punonjësit si më poshtë:*

■ *1 (një) Inxhinier Pyjesh, te licencuar **ne zbatim** ne kategorine 14:*

***Kat a** Punime ne siperfaqet e gjelberta, parqe pyll parqe*

***Kat b** Pastrim i siperfaqes urbane*

***Kat c** Kryerja e punimeve ne sherbesa furnerale*

***Kat d** Mirembajtja, zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane*

■ *Ne projektim **kategoria 2 e** ”Per projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte dhe parqe” për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.*

Te kete nje specialist te certifikuar nga organet shteterore (Ministria e Mjedisit) per projekte, zbatime dhe ekspertiza ne fushen mjedisit dhe gjelberimit), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 3.3/5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar si staf teknik i cili duhet të figurojë në licencën e shoqërisë për punonjësit si më poshtë:

- *1 (një) Inxhinier Pyjesh ,te licensuar **ne zbatim** ne katergorin 14:*

Kat a Punime ne siperfaqet e gjelberta, parqe pyll parqe

Kat b Pastrim i siperfaqes urbane

Kat c Kryerja e punimeve ne sherbesa funnerale

Kat d Mirembajtja, zhvillimi i dekorit ne mjediset urbane

Ne projektim **kategoria 2 e** "Per projektim peisazhi, sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte dhe parqe"

për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.

- Te ket nje specialist te certifikuar nga organet shteterore (Ministria e Mjedisit) per projektme, zbatime dhe eksperiza ne fushen mjedisit dhe gjelberimit)

III.1.2. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Neni 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.6. Në nenin 40 pika 5 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimi.

III.1.7. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se ankimuesi pretendon modifikimin e kriterit si vijon : Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ketë të punësuar përgjatë tre muajve të fundit staf teknik si më poshtë :

- 1 inxhinier pyjesh për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.
- Të ketë një specialist të certifikuar nga organet shtetërore (Ministria e Mjedisit) për projekte, zbatime dhe ekspertiza në fushën e mjedisit dhe gjelbërimit).

III.1.8. KSHA sqaron, se kërkesa për disponimin e një inxhinieri pyjesh është e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen. Nevoja për inxhinierin e pyjeve, është e domosdoshme nisur nga zërat e shërbimeve që kërkohen të realizohen për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pemëve, konstatimin dhe luftimin e sëmundjeve të ndryshme, kontrollin e krasitjes së pemëve dhe proceseve të tjera teknike, si dhe është i bazuar në legjislacionin për pyjet dhe shërbimin pyjor, ndërsa kërkesa, që inxhinieri i pyjeve të jetë i licensuar në zbatim me kategorinë 14, duhet të modifikohet nga AK, pasi një licencë e tillë nuk lëshohet aktualisht nga autoritetet përkatëse. Sa më sipër pretendimi i ankimuesit për këtë kriter qëndron pjesërisht, ndaj vlerësojmë, që kriteri të modifikohet nga AK dhe të hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, mbi inxhinierin e pyjeve të licencuar në projektim kategoria 2 e ”Per projektim peisazhi, sistemim

siperfaqe te gjelberta, lulishte dhe parqe”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik.

Sa më sipër, KPP vëren se pretendimet e ankimuesit për kriterin e sipërcituar janë pranuar pjesërisht nga autoriteti kontraktor. Konkretisht është pranuar kërkesa e ankimuesit për heqjen nga kriteri i veçantë i kualifikimit të kërkesës për inxhinier pyjesh të licencuar në zbatim në kategorinë 14 (kategoria a, b,c, d), por nuk është pranuar kërkesa për heqjen nga kriteri i kualifikimit për inxhinier pyjesh të licencuar ne projektim, kategoria 2 e ”Për projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbëria, lulishte dhe parqe”, për inxhinierin e pyjeve.

KPP gjykon, se sikundër ka arsyetuar KSHA në përgjigjen drejtuar ankimusit, kërkesa për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një inxhinieri pyjesh, është e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specififikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen. Nevoja për inxhinierin e pyjeve është e domosdoshme nisur nga zërat e shërbimeve që kërkohen të realizohen për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pemëve, konstatimin dhe luftimin e sëmundjeve të ndryshme, kontrollin e krasitjes së pemëve dhe proceseve të tjera teknike, si dhe është i bazuar në legjislacionin për pyjet dhe shërbimin pyjor. Por kërkesa e autoritetit kontraktor që inxhinieri i pyjeve duhet të figurojë në licencën e shoqërisë dhe të jetë i licensuar në projektim, kategoria 2 e ”Për projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte dhe parqe”, është e ekzgjertuar referuar edhe faktit, që në paragrafin e fundit të kriterit është kërkuar nga operatorët ekonomikë gjithashtu të kenë një specialist të certifikuar nga organet shtetërore (Ministria e Mjedisit) për projekte, zbatime dhe ekspertiza në fushën mjedisit dhe gjelbërimit). KPP gjykon, se qëllimi i autoritetit kontraktor përmbushet tërësisht me këtë kërkesë të fundit, pa qenë e nevojshme, që shoqëritë të dëshmojnë se disponojnë në stafin e tyre inxhinier pyjesh të licensuar në projektim, kategoria 2 e ”Për projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte dhe parqe”, për sa kohë që është kërkuar staf i certifikuar, pikërisht në fushën e projektimit, zbatimit dhe ekspertizës në fushën e mjedisit dhe gjelbërimit, kërkesë e cila përmbush qëllimin e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit, duke hequr kërkesën që inxhinieri i pyjeve të figurojë në licencën e shoqërisë, si dhe të jetë i licencuar në projektim, kategoria 2 e ”Për projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte dhe parqe”. KPP gjykon, se në rastin konkret mjafton që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, se disponojnë në stafin e tyre një inxhinier pyjesh për të cilin të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, si dhe një specialist të certifikuar nga organet shtetërore (Ministria e Mjedisit) për projekte, zbatime dhe ekspertiza në fushën e mjedisit dhe gjelbërimit).

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “6D Plan” SHPK në DT është ngarkuar vetëm një projekt dhe një relacion tre faqe. Në nenin 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2020 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik kërkohet që informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën: termat e referencës, grafikun e ekzekutimit, kërkesat për personelin kryesor, kërkesat e vecanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit. **Në dokumentacionin teknik të kësaj procedure mungojnë termat e referencës (relacioni është një përshkrim tejet i përciptë) dhe grafiku i ekzekutimit.**

Në termat e referencës minimalisht duhet të përcaktohet: objektivat specifike, rezultatet e pritshme, metodologjia e vlerësimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta gjatë zbatimit të kontratës. Monitorimi dhe raportimi i shërbimit etj.

AK minimalisht duhet të hartojë dhe të bëjë pjesë të dokumentacionit specifikimet teknike me informacionin si vijon: identifikimi dhe përshkrimi i shërbimit, proceset e punës, llojet e drurëve dhe pemëve. AK duhet të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e dokumentacionit. Mungesa e grafikut të realizimit të secilit shërbim është në kundërshtim me kuadrin ligjor”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Referuar kthim përgjigjes drejtuar ankimuesit rezulton se në përfundim të trajtimit të ankesës KSHA ka sqaruar si vijon: Gjithashtu gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit KSHA ka konstatuar se AK për procedurën në fjalë ka përdorur DT për shërbimet të cilat janë shfuqizuar pasi që prej datës 09.06.2021 mbështetur në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 APP ka miratuar DT për shërbimet me vendimin nr.02 datë 09.06.2021 Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit procedurë e hapur. Sqarojmë se në nenin 14 pika 1 të VKM parashikohet se: APP harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit për çdo lloj prokurimi sipas nenit 41 të LPP dhe çdo tip kontrate. Në nenin 98 pika 1 gërma c të LPP parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur ...konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme. Në zbatim të sa më sipër AK duhet të përdorte DT e miratuara së fundmi ndaj në këto kushte vlerësojmë anulimin e kësaj procedure prokurimi pasi dokumentet e tenderit përmbajnë gabime të rëndësishme dhe mangësi të konsiderueshme.

III.2.2. Në nenin 15 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik parashikohet se:

- Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.
- Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:
 - - termat e referencës;
 - - grafikun e ekzekutimit;
 - - kërkesat për personelin kryesor;
 - - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP vëren se si pjesë e dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike preventivin me zërat e shërbimeve, dhe disa relacione të cilat nuk japin një përshkrim të detajuar të shërbimit të kërkuar. Gjithashtu sikundër rezulton nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton se për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nuk janë përdorur dokumentet e reja të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik të dala në zbatim të ligjit 162/2020 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Sa më sipër, KPP gjykon të marrë në konsideratë arsyen e parashtruar nga autoriteti kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi në kushtet kur dokumentet e procedurës së prokurimit përmbajnë gabime dhe mangësi të rëndësishme të cilat nuk janë në përputhje me parashikimet e reja ligjore.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe në rishpallje të saj të plotësojë çdo mangësi dhe të metë në hartimin e dokumenteve të reja të procedurës së prokurimit. Konkretisht në rishpallje të procedurës autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë pretendimet e ankimuesit për publikimin e termave të referencës (objektivat specifike, rezultatet e pritshme, metodologjia e vlerësimit të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta gjatë zbatimit të kontratës. Monitorimi dhe raportimi i shërbimit etj), si dhe grafikun e ekzekutimit, duke dhënë një informacion të plotë e të detajuar të mënyrës dhe kohës së kryerjes së shërbimit për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurë,

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “6D-Plan” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-06882-09-30-2021, me objekt “Mirëmbajtje e gjelbërimit në hapësirat publike dhe varrezat e Bashkisë Himarë”, me fond limit 22,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01-10-2021, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për

zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “6D-Plan”sh.p.k.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri